

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRËZIDENTA OPSTINI/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 842 Nr. ifaq/Br.str./No pg. 180  
Data/Datum/Date 23/6/23  
RAHOVEC / ORAHOVAC



KOMUNA  
**RAHOVEC**

# RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS JANAR - QERSHOR

Qershori 2023

**PËRMBAJTJA**

KRYETARI I KOMUNËS .....	2
Zyra Ligjore.....	6
Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit .....	7
Zyra e Prokurimit .....	8
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun .....	8
Zyra e Auditimit të Brendshëm .....	10
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim .....	10
Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura.....	11
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË.....	14
DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET .....	18
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE.....	20
DREJTORIA PËR ARSIM.....	22
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM.....	23
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT.....	26
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	28
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL .....	30
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË .....	34
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT .....	35
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE .....	37
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM .....	38
PËRFUNDIM .....	40

**KRYETARI I KOMUNËS****Fjala hyrëse**

*Qytetarë të komunës së Rahovecit,*

*Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të komunës dhe Qeverisë komunale 2023, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush reportin gjashtëmujor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2023.*

*Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtiveve komunale në komunën e Rahovecit, si dhe të njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.*

*Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvisoja progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të komunës dhe ka si pikë referencë Programin e Qeverisë Komunale.*

*Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë komunale. Raporti gjashtëmujor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, i përkushtimit, i angazhimit dhe i vendosmërisë së treguar në përbushjen e detyrave dhe të obligimeve, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.*

## ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për lin;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësitet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

## PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administrati baslikëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

## PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2023

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të Moshuar;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim te Maja e Shkodranit;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim i Kullës për heronjtë Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici dhe bashkëluftëtarët e tyre, Hamdi Hajrizi, Nezir Imeri dhe Bektesh Haliti në Opterushë;
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Funksionalizim i plotë i çerdheve ekzistuese;
- Bursa për studentë;

- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e tituje të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinet;
- Përkrahje e fermerëve me serra, stalla, ferma të vogla, inpute dhe pajisje bujqësore;
- Rrugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinare periodike, falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujqë dñe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU "Gjakova" dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficiencia e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe i rrugëve në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedise të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe të cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- Tradita e investimit në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit do të vazhdojë përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturoro-artistike dhe klubeve sportive;
- Do të vazhdojë subvencionimi i projekteve kulturoro-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrrenjeve;
- PZHK dhe HZK - do të miratohet Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e komunës, pas shqyrtimit publik;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Investim në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, faza e dyte - instalimi i kabinave inovative në stacionet e pristes, në qytet dhe fshatra;
- Administratë efikase, e përgjegjishme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të rejat;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm,
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

## SYNIME PËR VITIN 2023

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Zgjerimi i sistemit të ujites në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrenjeve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Në bashkëpunim me Drejtoren e Urbanizmit dhe me Drejtoren për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerra e akteve dhe i rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

## SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

### Zyra Ligjore

- Zyra Ligjore ofron ndihmë juridike, shërbime dhe këshillime për drejtori, zyra dhe sektorë, institucionet dhe ndërmarrjet komunale;
- Shqyrton të gjitha projekt-rregulloret që propozuesit ua dërgojnë për miratim komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në suqi dhe Statutin e Komunës;
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale.
- Shqyrton propozimet e Rregulloreve dhe të akteve të tjera që i propozohen Kuvendit të Komunës për miratim;
- Përgatit dhe harton Rregulloret dhe urdhëresat administrative që i lëshon kryetari i Komunës;
- Ruan dokumentacionin e Zyrës Ligjore dhe bën përgatitjen e të gjitha materialeve dhe akteve të tjera nga përgjegjësia e kësaj zyre;
- Merr pjesë në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara;
- Merr pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të formuara nga Kuvendi i Komunës;
- Zyra si strukturë organizative kryen edhe punë të tjera që i caktohen me ligji, Statutin e Komunës dhe rregulloret e tjera në suqi.

Në periudhën janar – qershor 2023, Sektori Ligjor në Komunën e Rahovecit ka arritur këto objektiva:

Rregullore	1
Plotësim dhe ndryshim i rregulloreve	1
Vendime për kryetarin e Komunës	259
Vendime për Kuvendin e Komunës	51
Kërkesa nga kryetari i Komunës	3
Shkresa përcjellëse	1
Urdhëresa	53
Autorizime	9
Mendim juridik	1
Marrëveshje	6
Propozime për Kuvend	31
Kontrata	17
Konsultime	permanente

Përgjigje në kërkesë	5
Njoftime	3
Vendimet për Drejtori	8
Puna në Komisione	27
<b>Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-qershor 2023 nga Zyra Ligjore është:</b>	<b>476</b>

## Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

### 1. REKRUTIMET( Lëvizjet paralele dhe Ngritjet në detyrë)-Pranim

- 25 konkurse publike - 8 në shërbimin civil, 11 konkurse në Drejtorinë për Arsim, si dhe 6 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

### 2. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

- Njësia e Personelit, gjatë kësaj periudhe, ka hartuar gjithsej 95 shkresa administrative, si në vijim: kontrata, vërtetime, vendime, draft - vendime, propozime, akt emëreme, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera.

### 3. VLËRËSIMI I PUNËS PROVUESE

Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi pasur 9 raste të vlerësimit të punës provuese për punëtorë që i kanë bërë një vit pune në Komunë.

### 4. VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Funksionon Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP.

Njësia e personelit, rregullisht, në çdo muaj, u dërgon drejtorive komunale dhe zyrave reportin e vijueshmërisë së punës, dhe kërkon nga menaxhmenti që të verifikojë mungesat e punëtorëve në punë.

### 5. TRAJNIMET E NËPUNËSVE CIVIL

Udhëheqësi i personelit i ka njoftuar me kohë punëtorët për trajnimet.

Është hartuar Plani i trajnimit të nëpunësve civil të Komunës për vitin 2023 dhe është dërguar në DASHC/ MAP.

### 6. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE SIPAS PROGRAMIT “ SIMBNJ”.

Në vazhdimësi, Njësia e personelit menaxhon me programin elektronik SIMBNJ duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program, sipas kërkesave që parashtron MPB-ja.

### 7. ADMINISTRIMI I PROGRAMeve ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore, si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik *hrms.rks.gov-net*, ku realizohen procedurat e rekrutimit.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë të punëtorëve – pra programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED, që në nivel shtetëror është kompetent ASHI - Agjencionii i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programin e listave të pagave dhe të pagesave të komunës.

## Zyra e Prokurimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese gjashtëmujore të punës nga Zyra e Prokurimit, deri tani kemi proceduar 45 aktivitete të prokurimit. Vlera e parashikuar e këtyre aktivitetave është: 11,642,286.02 €. Deri më tani janë nënshkruar 24 kontrata të të gjitha prokurimeve: punë, furnizime, shërbime, ku vlera e kontratave të nënshkruara është: 1,102,170.88 €; Një (1) aktivitetet i prokurimit është në ankesë; Njëzet (20) aktivitete të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit Publik; Personeli i zyrës së prokurimit ka proceduar: 758 URDHËR BLERJE, pagesa të ndryshme të Investimeve Kapitale, Mallra dhe Shërbime, vlera e të cilave është: 4,357,112.66 €.

## Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023, ka vazhduar me përcjelljen e aktivitetave ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegzës zyrtare: <http://kk.rks-gov.net/rahovec>.

Në ueb - faqen e Komunës, janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente të tjera në interes të të gjithë qytetarëve të komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me medie, ku i ka përcjellë njoftimet e lajmet ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj. Gjithsej janë përgatitur dhe publikuar: 144 lajme, 30 njoftime, 20 ftesa, 9 thirrje, 13 ankande, 2 rregullore/ plane-strategji dhe 31 konkurse.

## Qasja në dokumente publike

Janë pranuar gjithsej 16 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe të gjitha kërkesave u është dhënë qasje - të gjitha kanë marrë përgjigje pozitive.

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i Komunës, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë dërguar te zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në ueb - faqen zyrtare të Komunës. Për këtë periudhë raportuese, kryetari ka nënshkruar 260 vendime.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve, si nga ministritë edhe nga OJQ-të, e që kanë pasur të bënin me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.

*Detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:*

Muajtë	Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Konkurse	Ankande	Rregullore/Plane/Strategji	Takime/Dëgjime Konsultime	Raport e-proces verbal	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitetë përmuanj
Janar	3	1	2	2	5	0	1	1	2	1	22	40
Shkurt	18	3	3	5	7	10	1	4	14	2	63	130
Mars	36	6	4	0	5	3	0	0	4	3	55	116

Prill	23	12	5	1	7	0	0	1	1	5	60	114
Maj	43	7	2	1	6	0	0	0	1	5	47	111
Qershor	21	1	4	0	1	0	0	6	6	0	13	52

### Sektori për Lektorim

Gjatë periudhës shkurt - qershor 2023, zyrtarja për lektorim, ka redaktuar gjuhësish dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtori, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara dhe punë të tjera rreth Kabinetit të Kryetarit.

Për më shumë detaje, tabela në vijim:

Vendime	220
Vendime të Kuvendit	6
Urdhëresa	22
Njoftime	9
Propozime	20
Marrëveshje	3
Raporte	6
Kontrata	14
Drejtori	44
Zyra e personelit	17
KKSB ( procesverbal dhe rend dite)	5
KPF (procesverbal dhe rend dite)	7
Kuvendi (procesverbal dhe rend dite)	7
Kuvendi Komunal ( Kërkesë për interpretim ligjor)	1
Komititi për Komunitete (procesverbal dhe rend dite)	5
Komititi për Shëndetësi (procesverbal dhe rend dite)	2
Informata	2
Autorizime	4
Kërkesa nga Zyra e Kryetarit	46
Përgjigje në kërkesa	4
Shkresa	2
Buletine mujore (redaktim gjuhësor dhe përpilime për publikim)	4
Thirrje	2
Gjithsej:	450

Vërejtje: Të gjitha të dhënat që janë të paraqitura në raport janë përgatitur deri më datë: 9.6.2023

## Zyra e Auditimit të Brendshëm

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën janar – qershor të vitit 2023, kemi arritur të kryejmë 2 (dy) auditime, dhe 1 (një) është në proces.

Drejtoritë e audituara, të planifikuara, dhe të realizuara, për periudhën janar – qershor të vitit 2023:

1. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shërbime Publike Komunale - auditim i përfunduar.
2. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm - auditim i përfunduar.
3. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - auditim në proces.

## Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

### ARSIM

Në periudhën janar - qershor 2023, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka zhvilluar një sërë takimesh dhe aktivitetesh përfunksionalizimin dhe përmirësimin e programit "Qendra Mësimore me Bazë në Komunitet/shkollë", në Shkollën "Gëzim Hamza-Piktori".

- I. Janë intensifikuar takimet me donatorët dhe MASHT-in përlenisim e Qendrës me Bazë në Komunitet, me ShFMU "GËZIM HAMZA - PIKTORI".
- II. Fasilitimi në aplikacionin përbursa dhe asistimi në kompletimin e dokumentacionit përxenësit dhe studentët e komuniteteve.

### SHËNDETËSI

- I. Nën mbështetjen e organizatës UNICEF dhe në bashkëpunim me OJQ "Ballkan Sunflower", dhe ZKKK, ka vazhduar procesi i vaksinimit të rregullt të fëmijëve 0-10 vjeç, dhe ka zhvilluar fushata sensibilizuese me gra të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbi rëndësinë e ushqyeshmërisë dhe të gjidhënieve.
- OJQ "Prosperiteti", në bashkëpunim me ZKKK-në, ka organizuar fushatë vetëdijësimi përmamografi dhe gjinekologji, përgatë e komuniteteve: rom, ashkali dhe egjiptian.

### RIATDHESIMI

- I. Janë trajtuar 5 raste të kthimit në komisionin përiatdheshim.
- II. Janë mbajtur trajnime për forcimin e mekanizmave përiintegrin e personave të riatdheshuar.
- III. Janë kryer vizita në terren te familjet e riatdheshura dhe janë nisur procedurat e mëtutjeshme, bazuar në rregulloren përiatdheshim.

### • KTHIMI I QËNDRUESHËM

- I. Është finalizuar databaza përkthim online në sistemin elektronik, dhe tanë pritet vetëm funksionalizimi i programit përkthim - RRK6.

## Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjore (ZPL) e Komunës së Rahovecit, kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

Zyra për Përfaqësim Ligjore mban regjistrat elektronik të lëndëve,

Regjistrat:

1. Regjistri për lëndë (procedurë) civile "C";
2. Regjistri për lëndë (procedurë) civile përmbarimore "CP";
3. Regjistri për lëndë (procedurë) konflikte administrative "KA";
4. Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme "CN";
5. Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit "PA" dhe
6. Regjistri për lëndë të brendshme administrative "ZPL".

1. PASQYRA TABELARE (SI MË POSHTË) PËR TË GJITHË REGJISTRAT, PARAQET LËNDË NË PUNË, TË PRANUARA, TË KRYERA, TË PAKRYERA DHE LËNDË TË MBETURA, SI DHE PASQYRA PËR AKTIVITETET E NDËRMARRA

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Sipas regjistrave të ZPL	Civile	Përmbarimore	Konflikt Administrative	CN Ndryshme	Proc. At hezionit	Komerciale Ekonomike	Gjithsej punë të kryera:
1	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	1573	206	12	35	17	1	1844
2	Lëndë të pranuara	159	121	0	0	0	1	281
3	Të gjitha lëndët në punë	1732	327	12	35	17	2	2125
4	Lëndë të zgjdhura	52	82	0	0	0	0	134
5	Lëndë të mbeturë	1680	245	12	35	17	2	1991

### 2. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2023:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Lëndë të reja të pranuara gjatë periudhës raportuese	Civile	Përmbarimore	Konflikte Administrative	Civile Ndryshme	Proc. At hezionit	Komerciale Ekonomike	Gjithsej lëndë të administratara
1	Vërtetim i pronësisë	5						5
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	144	119					263

3 Konteste pune	2						2
4 Lëndë të tjera	8	2	0	0	0	0	10
5 Komuna paditëse/kreditore	1						1
Gjithsej:	159	121	0	0	0	0	281

## 3. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

PARASHRTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezonit	Komerciale Ekonomike	GJITHSEJ
Aktvendim+Aktgjykim I	54	4	0	0	0		58
Aktvendim+Aktgjykim II	22	0	0	0			22
Aktvendim+Aktgjykim III	9		0	0			9
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	0						0
Urdhër përmbarimor		91					91
Aktvendim E për lejimin e përbartimit		17					17
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	147		0	0	0		147
Aktvendim për përgjigje në padi	0		0	0			0
Përgjigje në ankesë C	0		0	0			0
Përgjigje në ankesë P		0					0
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revizion	0						0
Përgjigje në propozim për ML	0						0
Precizimi i padisë	0		0				0
Prapësim i debitorit		0					0
Ankesë C e paditësit	1						1
Ankesë P e kreditorit		0					0
Revizion C i paditësit	0			0			0
Ekspertizat	0			0			0
Aktakuzë					0		0
Parashtresat e tjera	0	0		0			0
	233	112	0	0	0	0	345

Të gjitha shkresat e panuara janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës, varësisht nga rasti. Vendimet e pranuara gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës, janë ankimuar në shkallë tjetër gjyqësore.

Të gjitha vendimet gjyqësore të shkallës së parë, ku e paditur ka qenë Komuna e Rahovecit, janë ankimuar në afat ligjor.

**PARASHTRESA  
TË DËRGUARA**

	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIV E	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Departamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Ankesat	33	19	0	0	0		52
Përgjigje në ankesë	0		0	0			0
Përgjigje në paditë	112		0	0			112
Mbrojtje në paditë DHP GJS	0						0
Rezolucion	0						0
Përgjigje në rezolucion	0		0				0
Propozim për ML	1		0				1
Përgjigje në ML	0						0
Prapësimet		5					5
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i kundërpërmbarimit		0					0
Ushtrimi i padisë	0						0
Kundërpadi	4						4
Kallëzim Penal				0			0
Ushtrimi i propoz. për përmbarim	1	1					2
Parashtresat e tjera	5	0	0	0	0	0	5
Gjithsej:	156	25	0	0	0	0	181

**Seancat e caktuara nga kontestet civile, përbartimore, etj., nga gjykatat për periudhën raportuese**  
Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore, në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2023	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Nr.i seancave të mbajtura:	5	13	14	9	13	0	0	0	0	0	0	0	54
<b>Sipas kontesteve - seanca të caktuara/mbajtura</b>													
Civile						53							
Përbartimore						0							
Konflikte Administrative						0							
Civile - Ndrysime						1							
Proc.At - hezionit						0							
Gjithsej:						54							

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Administrata, si dikaster i rëndësishëm i Komunës, ka për objektiv punë sa më efikase e më afër qytetarit, komunikim korrekt me të gjithë, ka bërë afirmimin e punës së Administratës Komunale, shërbime të shpejta, si në formë fizike ashtu edhe në formë elektronike, ka trajtuar me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve, në mënyrë që qytetari të marrë shërbimin më lehtë e më shpejt.

### Në kuadër të Drejtorisë për Administratë, funksioninë disa sektorë:

- Sektori i Gjendjes Civile;
- Sektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve;
- Sektori për IT;
- Sektori për të Drejtat e Njeriut;
- Sektori për Barazi Gjinore;
- Sektori për Mirëmbajtje, Logistikë dhe Sigurim të objekteve.

Raporti gjashtëmuJOR i punës së Drejtorisë për Administratë të përgjithshme dhe të sektorëve në kuadër të drejtorisë, pasqyron punët e realizuara gjatë periudhës janar-qershori 2023, punë që janë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

### Sektori i Gjendjes Civile

Ky sektor ka kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile, siç janë: përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile, si dhe të veprimeve të tjera juridike administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Gjatë këtij gjashtëmuJORi, janë lëshuar:

Certifikata të lindjes	12479
Deklarata e bashkësisë familjare	2260
Statusi martesor	740
Certifikata e martesës	2585
Certifikata e shtetësisë	94
Certifikata e vendbanimit	974
Certifikata e vdekjes	512
Vërtetim nga arkivi	476

Lindjet vendore	13
Lindjet e jashtme	75

<b>Martesat vendore</b>	<b>196</b>
<b>Martesat e jashtme</b>	<b>7</b>
<b>Vdekjet vendore</b>	<b>24</b>
<b>Vdekjet e jashtme</b>	<b>14</b>
<b>Aktvdekjet</b>	<b>137</b>
<b>Pranimi i atësisë</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e korrigjimit të emrit ose të mbiemrit</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të lindurve</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të vdekurve</b>	<b>7</b>
<b>Aktvendimet e ndërrimit të emrit dhe mbiemrit</b>	<b>16</b>
<b>Anulimet e regjistimeve të dyfishuara me aktvendim</b>	<b>1</b>
<b>Aktvendimet e riregjistrimit të të vdekurve</b>	<b>1</b>
<b>Aktvendimet e riregjistrimit të të lindurve</b>	<b>3</b>

### Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve

Për të gjitha takimet e mbajtura të Kuvendit Komunal dhe të Komiteteve, kemi bërë përgatitjen profesionale të dokumenteve, përkthimin, lektorimin, kemi asistuar në mbarëvajtjen e seancave, kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku kemi dërguar aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës. Më poshtë, është i detajuar në mënyrë tabelare, numri i mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve të dala nga Kuvendi i Komunës, për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023.

Mbledhje të rregulla të Kuvendit	6
Komiteti për Politikë dhe Financa	6
Komiteti për Komunitete	4
Mbledhjet e KKSB-së	3
Komiteti për Shëndetësi	2
Komiteti për Arsim	0

Komiteti për Auditim	1
Mbledhje të jashtëzakonshme	0
Mbledhje Emergjente	0
Mbledhje solemne	2
Mbledhje komemorative	2

### Sektori për IT

Më datë 23 maj 2023, është lansuar në objektin e Komunës Sistemi i Menaxhimit të Radhës (One Stop Shop), i cili do të lehtësojë punën e zyrtarëve të Administratës, si dhe qytetarët do të marrin shërbime më të shpejta.

Kemi bërë rikonfigurimin e disa kompjuterëve, kemi bërë inspektimin e kompjuterëve, kemi monitoruar vazhdimi i securinë e punëve në sistemin e intranetit, kemi monitoruar funksionimin e ueb - faqes, po ashtu, me kërkesa të ndryshme, edhe kemi publikuar materiale në ueb - faqe. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha takimet e mbajtura në sallën e kuvendit komunal (mbledhjet e Kuvendit komunal, KPF, KKSB) dhe të të gjitha komitetave të tjera, i kemi përkrahur dhe, sipas nevojës, i kemi transmetuar në ueb - faqe të komunës.

Kemi monitoruar edhe zyrat e gjendjes civile në terren, jemi marrë me përgatitjen e specifikacioneve për projektet që ndërlidhen me teknologjinë informative, siç janë: Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, furnizimi me *digital sender* dhe i pajisjeve të teknologjisë informative, furnizimi dhe instalimi i kamerave në objektet e komunës, kemi zhvilluar procedurat për ndërtimin e dy E-Kiosqeve. Kemi mbikëqyrur funksionimin e pajisjeve për printim, kopjim dhe skanim të cilët na i ka furnizuar kompania *ArtHouse*.

Kemi pasur edhe kërkesa për krijimin e llogarive të reja për përdorimin e sistemeve qeveritare, të cilat i kemi krijuar dhe, në bashkëpunim me AHI-në, edhe i kemi autorizuar për përdorim.

Vazhdimi i kërkesa AD-HOC nga zyrtarët komunal, nga shkollat e komunës së Rahovecit, nga institucionet shëndetësore (QKMF, QMF, AMF) për intervenime në pajisjet e teknologjisë informative, të cilave po përpinqemi në maksimum t'u përgjigjemi.

### Qendra për Shërbime me Qytetarë

Qendra për Shërbime me Qytetarë është pjesë e strukturës organizative të administratës. Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë, të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ, si: pranimin e kërkësave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet e tjera. Këto kërkësa/parashresa, të kompletuara, përcillen në drejtoritë e Administratës komunale, varësisht ku pala parashtron për shqyrtim dhe vendosje. Komunikimin e drejtëpërdrejtë, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënien e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkësave dhe të parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative, ligjore, afatet kohore të paraqitjes dhe të trajtimit të kërkësave dhe të parashtresave, si në formën klasike, ashtu edhe përmes formës elektronike / intranetit, përgatitja dhe vënia në dispozicion e broshurave dhe e fletëpalosjeve informative për qytetarët, mbajtja e dosjeve, e statistikave të parashtresave dhe e kërkësave të paraqitura nga qytetarët, shtypja e librit të protokollit për kërkësat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe i zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

### Kërkesat e pranuara gjatë periudhës janar - qershori 2023

Në Drejtorinë e Administratës së përgjithshme, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë pranuar kryesisht kërkesa që kanë të bëjnë me kërkesat që janë drejtuar në drejtore të tjera e që, sipas rregullores për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa, kanalizohen përmes drejtorisë sonë.

Drejtoria e Administratës	Shenja e klasifikimit	Nr. i kërkesave	Të paguara	Të liruar	Gjithsej
Kërkesa/Ankesa	320/04	4024	4024	//	4024
Mbajtës familjeje	320/04	608/10euro	608	//	6080
Vërtetime te ndryshme	320/04	150	150		150
Totali					10254

### Sektori për Mirëmbajtje, Logistikë dhe Sigurim të objekteve

Sektori për mirëmbajtje, logistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave, ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë. Ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logistikë (pastrim, kujdes për gjelbërim etj...). Kemi përfunduar procedurat për projektin "Sigurimi fizik", të objekteve të Komunës. Kemi menaxhuar me përkushtim të plotë fushën e logistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar me përkushtim të plotë, sipas legjislacionit në fuqi, mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servismin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

### Sektori për të Drejtat e Njeriut

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, sektori për të Drejtat e Njeriut është angazhuar me të gjitha kapacitetet e saj për të afirmuar sektorin, ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ka këshilluar qytetarët, të cilët janë paraqitur në zyre. Bashkëpunim të ngushtë, sektori, ka pasur me zyrën e Avokatit të Popullit, me të cilët është punuar me theks të veçantë kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, pa dallim etnie e gjinie. Sektori për të Drejtat e Njeriut, duke pasur për bazë ligjet në fuqi, ka përsynim rritjen e vetëdijes qytetare për të kërkuar më shumë ndihmë në këto zyra, si objektiv parësor ka mbikqyrjen e legjislacionit vendor e ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut.

### Sektori për Barazi Gjinore

Në kuadër të Administratës, funksionon sektori për Barazi Gjinore.

Gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2023, zyrtari për barazi gjinore është angazhuar në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrimet e barabarta të gruas, ashtu siç parashihen me ligjet tona në fuqi dhe me konventa ndërkombëtare.

Përgjatë këtyre muajve, konfrom planit të punës për këtë vit, zyrtari ka bashkëpunuar me organizata vendore dhe të huaja, ka marrë pjesë në punëtori për avancimin e rolit të gruas në shoqëri, si dhe me shënimin e ditëve të shënuara ndërkombëtare, siç është Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi.

Sektori për Barazi Gjinore, ka objektiv rritjen e rolit të gruas në shoqëri, avancimin e saj në të drejtat që i takojnë, synim i cili do ta përcjellë punën e këtij sektori.

## DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

### 1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Në Drejtorinë e Financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyrë dhe shpenzim të evidentohet në sistemin e SIMFK-së dhe databazën e brendshme.
- Gjatë kësaj periudhe të punës, kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK-në dhe organizata të ndryshme apo donatorë, që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.
- Te shpenzimet Operative, kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime, të cilat në të kaluarën janë paguar nga Kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë: mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e rrugëve, sinjalizimet horizontale dhe vertikale, rrënimet e ndërtimeve pa leje, hartimi i projekteve, mbikëqyrje e projekteve etj., duke respektuar edhe asfatet ligjore, të cilat janë të rregulluara me ligjet për Financat Publike.

### 2. BUXHETI 2023

➤ Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2023, ndahet në dy fonde burimore:

- Grandi i qeveritar ..... 16,112,029.69 €
- Të hyrat vetanake ..... 1,445,603.00 €

Gjithsej:..... 17,557,632.69 €

➤ -Buxheti për vitin 2023, i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:

- Paga dhe Mëditje ..... 8,512,480.69 €
- Mallra dhe Shërbime..... 2,203,829.00 €
- Shpenzime Komunale ..... 370,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere ..... 820,000.00 €
- Investime Kapitale..... 5,651,323.00 €
- Rezervat..... 000.000.00 €
- Donacion..... 637,974.75.00 €

### 3. PUNËT E REALIZUARA JANAR-QERSHOR

➢ Gjatë kësaj periudhe, kemi realizuar këto detyra:


- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022, në vitin 2023.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë.
- Shpërndarja e vërejtjeve të tatimit në pronë.
- Përgatitja e raportit finansiar në baza tremujore 2023, për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.
- Raportimi i obligimeve financiare, dhe kontraktuale në baza mujore, në Ministrinë e Financave.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim, në ueb-faqen e Komunës

### 4. JANAR-QERSHOR - BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim Buxheti fillestar %	Shpenzim Buxheti final %	Shpenzim Alokim %
Paga dhe Mëditje	-	8,503,088.00	8,512,480.69	4,561,294.93	3,948,217.52	46.43	46.38	86.56
Mallra dhe Shërbime	1167	2,203,829.00	2,203,829.00	2,180,829.00	1,060,196.66	48.11	48.11	48.61
Shpenzime Komunale	291	370,000.00	370,000.00	370,000.00	170,667.95	46.13	46.13	46.13
Subvencione dhe Transfere	81	820,000.00	820,000.00	629,566.36	390,207.00	47.59	47.59	61.98
Investime Kapitale	95	5,651,323.00	5,651,323.00	5,402,124.95	2,584,623.85	45.73	45.73	47.84
Donacione	-	0	637,974.75	637,974.75	348,885.51	#DIV/0!	54.69	54.69
<b>Totali</b>	<b>1634</b>	<b>17,548,240.00</b>	<b>18,195,607.44</b>	<b>13,781,789.99</b>	<b>8,502,798.49</b>	<b>48.45</b>	<b>46.73</b>	<b>61.70</b>

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsyet e bartjes së mjeteve te mbetur nga viti 2022 në kategorinë e Investimeve kapitale, Donacionet, Grandi i Performancës, Alokimi i huamarries në Arsim dhe Shëndetësi, në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

#### 4.1. Paraqitja grafike



#### 5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake, të planifikuara për vitin 2023, janë: 1,445,603.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë: 598,099.35€, apo 41.37 % të planifikimit vjetor.

#### 6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës janar - qershor 2023, sektori i tatimit në pronë, ka realizuar të hyra në shumë prej: 595,671.78€, apo 75.35 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 790,514.00€). Regjistrimet e reja janë 169 objekte, ose 31,267 m<sup>2</sup>. Verifikimi i objekteve - 596 ose 83,947 m<sup>2</sup>.  
-Vërejtje: Të gjitha të dhënat, që janë të paraqitura, janë përgatitur në bazë të raporteve deri më: 8.6.2023.

### DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

#### AKTIVITETET

- Eshtë bërë shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave: 140 janë të miratuar dhe 12 të refuzuar;
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme;
- Eshtë duke funksionuar shërbimi mjekësor "Kujdesi shtëpiak", i cili do ta lehtësojë martjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata me sëmundje të rënda, të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja, apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime mjekësore nga ora 07:00, deri në 21:00. Janë kryer 191 vizita mjekësore shtëpiake nga ekipi mobil;

- Në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc, është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, po ashtu dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat: Krushë e Madhe, Sapniq dhe Dobidol;
- Janë mbajtur ligjërata vetëdijësuese në QKMF në Rahovec, me tema si: Pandemia COVID – 19, Vaksinimi AntiCovid, Trajtimi i prostatës me avull, Astma etj.;
- Është themeluar Këshilli i Pacientëve në Komunën e Rahovëcit, i përbërë nga 5 anëtarë, mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3(tre) - vjeçar;
- Në kuadër të marrëveshjes me AQH – në, po trajnohen mjekët dhe infermierët, në QKMF – në në Rahovec, po ashtu, AQH-ja asiston në implementimin e mjekësisë familjare;
- Një veturë donacion kemi pranuar nga UNICEF-i për shërbimin për vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë nga mosha 0 deri në 3 vjeç;
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovëcit.
- Jemi duke punuar në funksion të avancimit të shërbimeve shëndetësore dhe për këtë qëllim kemi pranuar Personel Shëndetësor për 42 vende të reja të punës, për: mjekë, stomatologë dhe infermierë;
- Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec, kemi vënë në funksion aparatin e mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovëcit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave, si shtyllë kryesore e familjes dhe e mirëqenies së saj;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrjet-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë;
- Ofrimi i shërbimeve në kuadër të kujdesit shëndetësor – 46533 shërbime janë ofruar për qytetarët e komunës sonë.

#### Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Kanë përfunduar punimet dhe bëhet përrimi i Objektit të vjetër të QKMF – së në Rahovec;
- Jemi pajisur me dy Autoambulanca për nevojat e QKMF-së.
- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale, nga buxheti i komunës.
- Nga donacioni, është pajisur me mjete laboratorike laboratori në QMF në Krushë të Madhe.

#### Mirëqenia Sociale:

Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

## DREJTORIA PËR ARSIM

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2023, në kuadër të planifikimeve të bëra nga Drejtoria Komunale për Arsim, u realizuan këto aktivitete të pasqyruara sipas tremujorëve:

### Aktivitetet gjatë muajve janar–mars

- Kanë vazhduar punimet e filluara në projektin e riparimeve të brendshme në shkollën “Bekim Sylka”, kanë vazhduar punimet edhe në eficiencë. Punimet, po ashtu, kanë vazhduar edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të ShFMU “Hamëz Thaçi”, në Xërxe;
- Kemi bërë përgatitjet e duhura për 2 projekte: projektin e furnizimit të shkollave me pakot pedagogjike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra;
- Takim me zyrtarët e divizonit për infrastrukturë në MASHT për fillimin e zbatimit të 2 projekteve nga niveli qendror, ai i çerdhes për fëmijë në qytet dhe projekt i për ndërtimin e objektit të shkollës në Pastasel;
- Kanë vazhduar punimet në përfundimin e projektit të riparimeve të brendshme në shkollën “Bekim Sylka”;
- Projekti i ndërtimit të objektit të ri të aneksit në ShFMU “Katër Dëshmorët” dhe projekt i riparimeve të nyjeve sanitare të shkollës në fshatin Sapniq;
- Mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj, me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12;
- Kanë përfunduar punimet në projektin e riparimeve të nyjeve sanitare të shkollës në fshatin Sapniq;
- Bashkë me përfaqësues të QPS-së, të Drejtorisë së Shëndetësisë, OJQ-të dhe me Shoqatën Down Syndrome Kosova, u koordinuam për aktivitete përkujdesjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta;
- U mbajtën ligjérata vetëdijesuese për sigurinë në komunikacion, në bashkëpunim me policinë;
- Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në objektin e ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq;
- Dorëzuam një kërkesë në MASHTI për pajisjen e IAAP-së me tri kabinete, në kuadër të thirrjes që kishte bërë MASHTI.

### Aktivitetet gjatë muajve prill – qershori

- Punimet për instalimin e ndriçimit të brendshëm, në objektin e ShFMU “Bekim Sylka”.
- Bursa për studentët dhe për nxënës të shkollave të mesme;
- Projektet e eficiencës dhe të renovimeve të brendshme në objektin e ShFMU “Bekim Sylka”;
- Vazhduan punimet në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në ShFMU “Katër Dëshmorët”;
- Projekti i eficiencës: ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, në Zatriq, ShFMU “Rilindja”, në Çifllak, ShFMU “Faik Konica”, në Celinë;
- Ka vazhduar ndërtimi i objektit të ShFMU “Hamëz Thaçi”;
- Përgatitëm dhe dërguam në MASHT projektin ideor të Çerdhes për Fëmijë, që pritet të ndërtohet në qytet;

- U shënua Dita e Tokës me aktivitete pastrimi me të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave;
- Furnizimi i plotë me libra për bibliotekat e shkollave;
- Në IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici" u përvura themelimi i Qendrës për Zhvillimin e Karrierës;
- U zhvilluan vizita në monumente nga nxënësit e shkollave të mesme të larta;
- Përurimi i objektit të ri të ShFMU "Bajram Curri";
- Furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike;
- Përurimi i 2 çerdheve për fëmijë në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc;
- Organizuam dhe mbajtëm garën komunale të diturisë ndërmjet nxënësve nga klasa e tretë deri në klasat e 12-a.

### **DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM**

Gjatë periudhës janar-mars të 2023, DEZHT-i ka bërë regjistrimin e të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022 dhe regjistrimin në librin e ri të vitit 2023, po ashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023.

Gjatë periudhës janar-qershori, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka përgatitur disa pikë drejtar Kuvendit Komunal të Rahovecit:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022;
- Plotësim-ndryshim i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20;
- Shfuqizimi i vendimit për fabrikën e kartonit, si dhe vendimi për dhënie në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit;
- Falja e borxheve të vjetra në taksa afariste për periudhën 1.1.2000 - 31.12.2017;
- Vendimi për dhëni në shfrytëzim përmes ankandit publik të 4 parcelave te depot e Matreksit në Xërxë. Në këtë ankand ka pasur një aplikant i cili tashmë ka kontratë;
- Vendimi për dhëni në shfrytëzim të lokaleve te palestra, ku në këtë ankand kanë ofertuar 2 aplikantë për dy lokale të ndryshme dhe jemi në procedurë të lidhjes së kontratave.

Janë mbajtur 3 sesione informuese:

- Sesion informues rreth aplikimit për grante në fonde të IPA-s;
- Sesion informues për grante. Ky sesion informues është organizuar nga Syri Vizion në bashkëpunim me DEZHT-in;
- Sesion informues për thirjen e granteve për bizneset, të cilën e ka hapur Minisitria e Zhvillimit Rajonal. Ky sesion informues u organizua nga DEZHT-i, në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal;
- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në bashëpunim me DEZHT-in, ka ndarë 66 kuponë me vlerë nga 100 deri në 300 euro, për familjet e prekura nga vërshimet, të cilat janë në kushte jo të mira ekonomike;

- Është mbajtur takimi i dytë i këshillit publiko-privat, ku u diskutuan çështje të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal në Rahovec;
- Në muajin prill, DEZHT-i ka iniciuar ankandin publik për shitjen e aseteve të papërdorshme komuale. Përmes këtij ankandi u mundësua shitja e shumë asteve të cilat nuk janë përdorur për arsyet e demtimeve dhe të vjetërisë. Vlera e aseteve të shitura është: 12,950.00€;
- Me datë 27 dhe 28 prill, kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit, i cili u mbajt në Prishtinë. Në këtë panair u prezantuan monumentet e trashëgimisë kulturore, si dhe pikat turistike të komunës së Rahovecit. Në këtë panair, bashkë me ne ishte edhe pronari i bodrumit Kosova Wine;
- Me datë 15 maj 2023, kemi marrë pjesë në konferencën Diaspora Flet, ku kemi prezantuar projektin e Parkut Industrial në Opterushë, projekt ky i cili do të ndihmojë në rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës sonë;
- Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me ndërmarrjet private, Bashkë me drejtorin e Bujqësisë, Berat Duraku, i kemi vizituar 3 biznese të mëdha në Komunën e Rahovecit: Stone Castle, Osa Termosistem dhe Haxhijaha. Në këtë vizitë u diskutua mundësia e organizimit të një praktike me pagesë për të rintjtë e komunës sonë – më pas është hapur edhe thirrja publike për aplikim.

#### Investimet Kapitale:

- Me 27.3.2023 ka filluar faza e parë e ndërtimit të Parkut Industrial në Opterushë, projekt ky i cili kap shumën 1,688,216.52€. Për këtë projekt, Komuna e Rahovecit, ka memorandum bashkëpunimi me MINT, ku vlera e bashkëfinancimit nga komuna do të jetë 300,000.00€;
- Kanë përfunduar të gjitha punimet në projektin: “Renovimi i shtëpisë së verërave” dhe jemi në proces të pranimit teknik;
- Kanë vazhduar punimet në projektin: “Rregullimi i Oborrit te Depot e Matreksit në Xërxe” dhe jemi në përfundim të punimeve;
- Ka përfunduar ndërtimi i vrazhdë i projektit: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, ka përfunduar instalimi elektrik, instalimi ujit dhe tani janë duke u kryer punët me suvatim.
- Kemi përgatitur paramasën për projektin: “Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit”;
- Është duke u përgatitur paramasa për projektin: “Investime në Turizëm”

#### Sektori për Ekonomi:

Në tremujorin e parë të vitit 2023, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale.

#### Të hyrat dhe ngarkesat në taksë komunale:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, periudha janar-qershori 2023	26,223.50€

**Sektori për Zhvillim**

Evidenca e të hyrave dhe e ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar - qershor 2023, janë lëshuar gjithsej 54 (pesëdhjetë e katër) pëlqime të punës.

- Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-mars dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- qershor 2023	35,154.61 €

**1.4. Zyra e QKRB-së:**

Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkесave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhen janar-qershor 2023:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	83
2	Informata të ndryshme	99
3	Vërtetim individual	17
4	Biznese të njësisë	0
5	Shuarje të biznesit	25
6	NUI	26
7	Ndryshim statuti nga B.I. në SH.P.K.	03
8	Ndërrim të emrit tregtar dhe informata të tjera	02
9	Ndërrim i pronarit, shtim i pronarëve	59
10	Certifikatë e dëmtuar	10
	Gjithsej lëndë të përfunduara	335

**Menaxhimi i Aseteve komunale**

Sektori për asete komunale ka regjistruar me kohë të gjitha transakzionet e vitit 2023

**Sektori i Turizmit**

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka

zbatuar detyrat dhe obligimet e muajve janar-mars 2022 si në vijim:

Janë mbajtur takime të rregullta me organizaten e UNDP-së, në lidhje me projektin për Programin Rajonal 2, ReLOAD2.

Në kuadër të turizmit, është lansuar Harta Turistike Dixhitale në komunën e Rahovecit, ku përmes sistemit CR cod, mundësohet promovovimi i atraksioneve turistike dhe i monumenteve të trashëgimisë kulturore. Kjo hartë është e pasuruar me 108 objekte turistike dhe kulturore.

### DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit;
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Të hyrat buxhetore në DUPMM (në gjashtëmujorin e parë) për vitet 2022-2023

Viti	2022	2023
Të hyra janar - qershori	23,773	32,074.44

Kërkesat për gjashtëmujorin e parë për vitet 2022-2023

Janar - qershori	2022	2023
Leje ndërtimore	26	36
Leje mjedisore	10	22
Leje rrënimë	6	4
Kushte ndërtimore	44	53

### SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit, janë shqyrtuar:

	Janar – qershori 2023				
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hidhet
Leje ndërtimi	36	30	1	5	
Leje rrënimë	4	4			
Leje përdorimi	2	2			
Kushte ndërrimore	53	31	4	11	7
Shkresa	25	25			
Pelqim ndërrim-destinim	37	26	4	5	1 hidhet 1 cedohet 1 cedohet
Ankesa	1				1 cedohet
Referanca	1	1			
Vertetim	1	1			
Gjithsej	160	120	9	21	10
Lëndë të vitit 2022	7	4			3

Të hyrat e përgjithshme janar - qershori 2023

<b>Paralogaria</b>	<b>15,848.90 €</b>
Leje përdorimi	40 €
Leje rrënim	20 €
Vendim	10 €
Vërtetim – pëlqim	1,445 €
<i>Totali i të hyrave</i>	<b>17,363.90 €</b>

### SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të sektorit të mjedisit, lëshojmë Leje mjedisore komunale dhe Leje ujore komunale.

<b>Janar - qershori 2023</b>					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hidhet
Leje mjedisore	22	18	2	2	

Të hyrat e përgjithshme në Sektorin e Mjedisit janar - qershori 2023

<b>Leje mjedisore</b>	<b>4699.57</b>
-----------------------	----------------

#### Sistemi i adresave

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është angazhuar Stafi Mbështetës për rrjedhat e procesit të Kompletimit të Sistemit të Adresave, detyrë e zyrtarit të angazhuar është harmonizimi i emrave të rrugëve në ARIS, ndryshimi i formave të rrugëve (ndarje/bashkim kodesh), kontrolli i hyrjeve sipas metodologjisë së caktuar dhe përgatitja në statusin “gati për aprovim” për t’i paraqitur në Gjeoportal dhe shfrytëzim nga qytetarët dhe institucionet.

Në gjashtëmuorin e parë janë mbledhur të dhëna për këto vendbanime: Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagavc, Nashpall, Zogisht, Hoçë e Madhe, Opterushë, Retijë, Retijë e Poshtme, Bërnjak, Patacan i Epërm, Patacan i Ulët, Sapniq, Xërxë, Gexhë, Malësi e Vogël, Bratotin, Vrajakë, Ratkoc, Dejnë, Çifllak, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor, Dobidol, Kaznik dhe Pastasell.

#### Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Plani Zhvillimor Komunal ka kaluar në fazën e shqyrtimit publik, është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për t’u pajisur me pëlqim pëmiratim.

#### Ndërtimi i Sheshit Qendor në Qytet

Sheshi Qendor është projekti më i madh që është realizuar ndonjëherë në Komunën e Rahovecit. Përmes këtij projekti, synojmë që të kemi qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, e në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu, synohet edhe krijimi i mundësive të reja për biznes dhe rritja e cilësisë së jetës urbane.

- Shënimi i Ditës së Tokës
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit

Në bashkpunim me asociacionin Pamkos, është organizuar aksioni i pastrimit “Drini rrjedh i lirë pa plastikë”

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale:

- Objekti i Banimit Social - ky objekt është drejt përfundimit;
  - Rregullimi i shtratit të përroit në lagjen e Kelmendve në Kramovik;
  - Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i Lumit Rimnik në Fortesë, kanë filluar punimet me ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza;
  - Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit, ku përfshihen ndërtimi i parqeve në fshatrat: Kramovik, Gur i Kuq, Brestoc, Xërxe, Pataqan i Epërm, Çifllak, Drenoc, Krushë e Madhe, Ratkoc.
- Parku në Ratkoc ka përfunduar, në Krushë të Madhe, Pataqan të Epërm, Çifllak, Gur të Kuq dhe Brestoc janë drejt përfundimit;
- Sheshi “Republika”- gjatë këtij muaji, operatori do të rikthehet në punime për përbillyjet e projektit;
  - Rregullimi i shtratit të përroit në Krushë të Madhe, është bërë pastrimi i shtratit deri në Dri të Bardhë;
  - Rregullimi i shtratit të përroit në Malësi të Vogël - ka vazduar ndërtimi i pjesës së mbetur;
  - Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve, janë rregulluar hapësira publike.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Në vazhdim, DSHP-ja ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore:

### Aktivitetet në periudhën: janar-mars

- Gjatë muajit janar, tre kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit, janë angazhuar në mirëmbajtjen e rrugëve dimërore, edhe pse nuk ka pasur të reshura të borës, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e disa problemeve me ndriçim publik, të gjitha këto janë pjesë e garacionit të projektit të zgjerimit të ndriçimit publik;
- Ka pasur takime me donatorët për zgjerimin e kamerave të sigurisë që përfshin fazën e dytë, rrugën tranzite dhe fshatin Hoçë e Madhe, takime me donatorë italian për panela solare, takime me donatorin JICA për reformat në menaxhim të mbeturinave;
- Është aprovuar Plani për Vlerësimin e Rrezikut;
- Është aprovuar Plani i Mobilitetit;
- Është aprovuar Plani i Transportit Rrugor Lokal;
- Ka pasur intervenime emergjente në disa pozicione, në rregullimin e trotuarit “Avdullah Bugari”, në largimin dhe mirëmbajtjen e deponisë legale inerte;

- Donatori tjetër është JICA japoneze, që është pjese e programit mbështetës për reformat në menaxhim të mbeturinave, si dhe ofrimin e pajisjeve për menaxhim të mbeturinave të vëllimshme;
- Punimet në rrugën 4 – korsi - ka pasur zhvillime në ndërtim të rrugës në 3 lote, punimet janë duke vazhduar;
- Janë duke vazhduar punimet në kontratën e rrugëve lokale, punimet janë realizuar në fshatin Nagac - 2 rrugë (150m), Hoçë e Vogël - 5 rrugë (800 metra), Rahovec - 10 rrugë (2000 metra), Brestoc - 3 rrugë (500 metra), 5 rrugë në Pastasel (1.3 km), Sapniq - 2 rrugë (250 metra);
- Janë bërë disa intervenime në përmirësimin e disa trotuareve të demoluara, te palestra “Mizahir Isma” dhe vende të tjera sipas nevojës;
- Ka vazhduar pastrimi i deponive legale të mbeturinave, Rahovec, Çifllak, rruga rajonale Rahovec-Suharekë, rruga rajonale Rahovec – Malishevë, Drenoc;
- Janë në përfundim të ndriçimit publik fshatrat Vrajak, Bratasin, Senoc, Pastasell;
- Ka përfunduar krasitja e drunjve dekorativë në qytet dhe në disa fshatra nga kompanitë e kontraktuara;
- I janë dërguar kërkesa KEDS-it nga ana e Komunës se Rahovcit, si plani investiv dhe kërkesat e qytetarëve për vitin 2024;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa intervenime emergjente në rregullimin e disa ujëmbledhëseve, është bërë rregullimi i trotuareve në Malësi, në Çifllak, si dhe do të kujdesemi edhe në disa zona të tjera për shkak të demolimit;
- Për 8 muaj, Komuna e Rahovcit ka shpërndarë donacion kontejner në bazë te grantit të fituar për mjesid te pastër - 6572 kontejner 120 L, 230 kontejner 1m<sup>3</sup> për zonën urbane dhe për institucione, ndërsa për periudhën që po raportojmë, komuna jonë ka fituar kamion në vlerë 156,000.00 për mbledhjen e mbeturinave.

### Aktivitetet në periudhën: prill-qershori

- Jemi në proces të disa punimeve me rëndësi kapitale në qytet, ndërtimi i kanalit për devijimin e lumit Duhlo ka përfunduar, si dhe te gjitha instalimet e tjera në rrugën “Shej Mihedini” dhe në rrugën “Ali Sokoli”;
- Gjatë kësaj periudhe jemi kujdesur në mirëmbajtjen e hapësirave publike, në pastrim të rrugëve dhe të hapësirave të tjera rrëth institucioneve, si: parqe, oborre, lapidare, si dhe ka filluar eleminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Jemi në proces të ndërtimit të trotuareve - në Rahovec, në rrugën “Tafil Zyberaj”, kanë përfunduar trotuaret me gjatësi 700 metra, po përfundojnë trotuaret në Pataqan, me gjatësi mbi 1500 metra, do te vazhdon në Nashpall, me 1500 metra;
- Është bërë marrëveshja e re me KRU “Gjakovë” për trajtimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- Ka filluar puna në draftin e ri të dokumentit për energji dhe klimë.

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, janë sektorët kryesorë të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Komuna e Rahovecit, përmes politikave dhe strategjive zhvillimore, është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijuimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji, janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

### Aktivitet gjatë muajve janar-mars

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmuajrin e dytë të vitit 2022 për fermerët blegtore (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga **12 janar, deri më 10 shkurt 2023**. Gjithsej kanë aplikuar **81** blegtore, prej të cilëve: 73 blegtore kanë qenë aplikues vetëm për qumësh/litër, sipas kategorive të cilësisë, me rreth **1.862.692 litra**, ndërsa **16** prej tyre kanë aplikuar edhe për viça për majmëri, gjithsej për **278** krerë.
- Kemi mbajtuar kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2022. Shumë fermerë kanë pasur probleme me llogari bankare, ku është kërkuar nga ne që t'i ndryshojmë në mënyrë që të realizojnë pagesat e tyre, po ashtu i kemi informuar fermerët për çdo informacion që ata kishin nevojë.
- Është bërë pritja e fermerëve në mënyrë individuale apo edhe grupore, duke iu dhënë informata lidhur me procesin e kompensimit të dëmeve.
- Gjatë muajit janar, për shkak të sasisë së lartë të reshjeve, kanë ndodhur disa vërvshime në tokat bujqësore, si pasojë e prurjeve të mëdha të ujit dhe të daljes nga shtrati të lumi Drini i Bardhë, kemi pranuar informata nga disa fermerë që u janë shkaktuar dëme dhe të cilëve më pas iu kemi pranuar kërkuesat e tyre dhe është përpiluar raporti.
- Kemi pranuar nga MBPZHR-ja listat e fermerëve të dëmtuar nga vërvshimet dhe breshëri gjatë vitit 2022, për të cilët ne kemi dërguar dy ankesa, të cilëve u është aprovuar ankesa, dhe atyre që janë refuzuar. Ankesa u është aprovuar gjithsej **243** fermerëve në vlerë rreth **1,060,000€**, ndërsa u është refuzuar gjithsej **83** fermerëve, në vlerë rreth **254,000€**.
- Është bërë pritja e fermerëve në mënyrë individuale apo edhe grupore, duke iu dhënë informata lidhur me procesin e kompensimit të dëmeve.
- Kemi përgatitur një ankesë dhe e kemi dërguar në MBPZHR për fermerët që janë refuzuar të cilët gjithsej janë **83** fermerë në vlerë rreth **254,000€**, ankesën e kemi dërguar për fermerët të cilët kanë siguruar dëshmi dhe janë paraqitur në zyrat e DBPZHR-së, mirëpo përmes një e-maili nga MBPZHR-ja, jemi njoftuar se ankesën që e kemi dërguar për **83** fermerët e refuzuar. Listën me emrat e këtyre fermerëve dhe të dhënënat tjera i kemi përcjellë te organizata FAO, ku kemi kërkuar që të kompensohen fermerët e dëmtuar dhe të refuzuar nga Komisioni në kuadër të Ministrisë.
- Është bërë shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qira, gjithsej **8** për herë të parë dhe **2** të rishpallura. Janë hapur ofertat dhe janë lidhur kontratat me përfituesit e përzgjedhur nga komisioni.

- Kemi pranuar kërkesat e bujqve për vlerësim të dëmeve, nga disa vërvshime në tokat bujqësore si pasojë e prurjeve të mëdha të ujët dhe të daljes nga shtrati të lumi Drini i Bardhë, është formuar komisioni i cili ka dalë në terren për vlerësim të dëmeve të shkaktuara.
- Gjatë gjithë javës së parë të këtij muaji, jemi angazhuar me mobilizimin e zyrave në Ratkoc dhe Krushë të Madhe pasi kanë filluar me aplikimin për pagesa direkte - subvencione, në fillim të muajit për sektorët: Blegtori, Bletari dhe Shpezëtari, ndërsa aplikimi për subvencionet në sipërsaqe ka filluar më 17 mars. Ne si drejtori kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqve.
- Vaksinimi nga veterinari - gjithsej janë vaksinuar rreth 1940 krerë.
- Në bashkëpunim me MBPZHR-në dhe IFC-në, është mbajtur sesion Informues lidhur me Sigurimet Bujqësore, janë informuar bujqit për produktet që mund t'i sigurojnë nga fatkeqësitë natyrore. Në këtë takim, komuna e Rahovecit, mori përsipëri mbulojë 15% të primit të sigurimit të produkteve bujqësore.

### Aktivitetet gjatë muajve prill-qershor

- Ka vazhduar aplikimi për pagesa direkte - subvencione, aplikimi ka qenë më 14 prill.
- Ka filluar të zbatohet kontrata "Trajtim i qenve endacakë"
- Organizata "Syri i Vizionit", në bashkëpunim me DBPZHR-në dhe DEZHT-in. Ky sesion u mbajti në kuadër të projektit "Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë" të finansuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancuar nga "Brot für die Welt".
- Është mbajtur takim për fermerët të cilët kanë shprehur gatishmërinë për sigurimin e kulturave bujqësore në kompanitë e sigurimit për: vreshta, grurë, misër, fasule, patate etj. Komuna e Rahovecit, ashtu sikurse vitin e kaluar, do të mbulojë 15% të vlerës, ndërsa 75% e ka marrë përsipëri Ministria e Bujqësisë.

### Subvencionet 2023

Aplikimi për subvencionet në sipërsaqe ka filluar më datë 17.3.2023 dhe ka mbaruar më datë 14.4.2023. Ne si drejtori e BPZHR-së, jemi angazhuar të mobilizohemi me zyre në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha. Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2023 është 3,119 ku krahasuar me vitin 2022 kemi 141 aplikacione më shumë.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit, zyrtarët e angazhuar e kanë bërë kontrollimin e secilës dosje dhe të njëjtat janë dorëzuar në AZHB (Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë).

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë, bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna më pastaj përllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

Në tabelat dhe grafikonet më poshtë janë paraqitur të dhënat sipas sektorëve të shprehura në sipërsaqe (ha), si dhe në vlera monetare (€) që nënkupton se komuna e Rahovecit do të përfitojë mbi 5,7 milion euro në vitin 2023, rrëth 270,818 € më shumë se në vitin 2022.

**Tabela 1. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023 të shprehura në sipërsaqe**

# RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS JANAR - QERSHOR 2023

Sektori i Lavërtarisë	Dritërat	ha	3,711.24	4,768.34
	Grurë - KG	kg	0.00	0.00
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	ha	2,322.21	2,274.57
	Verë	litër	7,274,876.45	7,654,411.00
	Fidane të hardhisë	copë	149,900.00	
Sektori i Perimkulturës	Perime	ha	1,213.94	1,114.97
	Kungullore	ha	579.58	423.16
Sektori i Pemtarisë		ha	165.23	194.31
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	koshere	4,245.00	4,793.00
	Lopë	krerë	1,938.00	1,953.00
	Dhi	krerë	248.00	167.00
	Dele	krerë	7,226.00	7,396.00
	Pula vojëse	copë	59,100.00	60,260.00
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA			16.51	8.54
Perime ne Serra	Te ndryshme	ha	24.26	27.21

Tabela 3. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023 të shprehura në EURO

Sektori i Lavërtarisë	Drithërat	1,255,391.96 €	1,627,232.86 €	371,840.90 €
	Grurë - KG	0.00 €		0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,447,609.34 €	2,397,396.78 €	-50,212.56 €
	Verë	290,995.06 €	290,995.06 €	0.00 €
	Fidane të hardhisë	22,485.00 €	18,600.00 €	-3,885.00 €
Sektori i Perimkulturës	Perime	689,203.76 €	636,805.38 €	-52,398.38 €
	Kungullore	210,956.32 €	175,984.14 €	-34,972.18 €
Sektori i Pemtarisë		74,353.50 €	97,932.24 €	23,578.74 €
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	84,900.00 €	95,860.00 €	10,960.00 €
	Lopë	174,420.00 €	175,770.00 €	1,350.00 €
	Dhi	6,200.00 €	4,175.00 €	-2,025.00 €
	Dele	180,650.00 €	184,900.00 €	4,250.00 €
	Pula vojëse	27,339.66 €	30,130.00 €	2,790.34 €
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA		7,429.50 €	4,304.16 €	-3,125.34 €
Perime ne Serra	Gjithsej	21,931.04 €	24,597.84 €	2,666.80 €
		5,493,865.14 €	5,764,683.46 €	270,818.32 €

## Shpërndarja e pajisjeve bujqësore

Më 28.4.2023 është bërë shpërndarja e 42 pllugjeve 5 – brazëshe.

Më 6.6.2023 është bërë shpërndarja e 149 motokultivatorëve dhe 5 pllujgjëve 5 – brazdësh.

## Projektet e investimeve kapitale

### Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore:

Lot 1 – Kanë filluar punimet në Krushë të Madhe në segmentin Vija e Rrasës, që i lidhë rrugët “Udhë Bjeshke” dhe “Udhë Perove”. Po ashtu punimet janë duke vazhduar në rrugën “Udhë Nallii”.

Lot 2 - Pas përmirësimit të kushteve atmosferike kanë rifilluar punimet, aktualisht është duke u punuar në fshati fshatin Gur i Kuq, konkretisht në rrugën që lidh dy vendbanime Gur i Kuq - Polluzhë.

Lot 3 - Punimet po kryhen në qytetin e Rahovcit, konkretisht në vendin e quajtur Sejan, janë duke u rregulluar rrugët vreshtarë.

Lot 4 - Ka vazhduar mirëmbajtja nëpër lokacione të ndryshme si në përmirësimin e rrugëve po ashtu edhe në vendosjen e lëshesave sipas kërkesave të fermerëve të komunës sonë.

### Kanalet e kullimit

**Kanali i Kullimit në Ratkoc** – në maj, Operatori Ekonomik që ka kontratë me komunën tonë, ka rifilluar punimet në ndërtimin e këtij kanali. Si rezultat i kushteve jo të mira atmosferike, punimet nuk janë zhvilluar me intensitet të lartë, dhe në disa raste edhe janë ndërprerë për shkak të prurjeve të mëdha të ujërave në këtë pjesë.

**Kanali i Kullimit nga Shtavica deri në Fortesë** - Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit prej betoni nga Fortesa në drejtim të Rahovcit, aktualisht është duke u ndërtuar ura e cila do t'u shërbejë fermerëve për qasje më të lehtë.

**Kanali i Kullimit në Çifllak** - kanë rifilluar punimet, fillimisht në gjërmim dhe hapje të kanalit përgjatë hekurudhës, do të bëhet riparimi në segmentin e ndërtuar në vjeshtën e vitit të kaluar dhe më pastaj do të vazhdojë betonimi i segmentit të ri deri në lumin “Drini i Bardhë”.

**Kanali i Kullimit Fortesë–Celinë** – ka përfunduar edhe segmenti i dytë i kanalit të drenazhës me fi:160. Aktualisht është duke u punuar në segmentin 3, po ashtu ne vendosjen e gypave të drenazhës fi: 160 dhe do të fillojë ndërtimi i kanalit kryesor me gypa fi: 1000 nga betoni.

### Pastrimi i përrenjve

Si rezultat i reshjeve të vazhdueshme dhe i vërvoshimeve që na janë shfaqur viteve të fundit, kemi lidhur kontratë për pastrimin e përrenjve në tërë territorin e komunës sonë. Punimet janë zhvilluar në zonat më të ndjeshme dhe që janë më të rrezikuara në Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe, Ratkoc, Vrajakë etj. Është punuar në hapjen dhe pastrimin e përroit ‘‘Bellaja’’, nga hekurudha deri në magjistrale Prizren-Gjakovë dhe kanë vazhduar deri te lumi “Drini i Bardhë” me gjatësi treth 3 km, kanë përfunduar punimet në përruin e fshatit Celinë me gjatësi 1.1 km, është punuar edhe në pastrimin e përroit nga Ratkoci në drejtim të fshatit Vrajakë me gjatësi 850 m.

### **DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË**

Gjatë periudhës gjashtëmujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	275	15,000 €
Gjeodezi	195	10,000 €
Referenti	2,200+65 L.Z.	7,700 €
Totali	2,670+65 L.Z.	32,700 €

**Gjatë muajve janar-mars, i kemi përfunduar këto punë:**

Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj. Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani.

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si koordinata, modifikime dhe punë të tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve.

Kemi përgatitur materialin për propozim - ndryshim të rregullores për taksa dhe tarifa, vendim për dhënien e pronës me qira, interes i përgjithshëm etj.

Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovaur me kohë në intranet.

Me kërkesë të qytetarëve të fshatrave Kramovik dhe Polluzhë, kemi përgatitur material për mbledhje të kuvendit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve për nevojat e komuniteteve, me kërkesë të qytetarëve kemi përgatitur material për dhënien e pronës me qira në ZK Rahovec, konkretisht te Maja e Shkodranit.

Pergjigje në kërkesat e KF "Rahoveci".

Kemi mbajtur takimet e rregullta me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

**Gjatë muajve prill-qershor, i kemi përfunduar këto punë:**

Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj.

Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani.

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si koordinata, modifikime dhe punë të tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve.

Bashkë me inspektoratin kemi dalë në terren në ZK Rahovec dhe në ZK Xërxe, konkretisht në parcelat ku tashmë ka filluar të ndërtohet Sheshi Qendor i Qytetit, kemi hasur në uzurpim të pronave publike dhe

janë iniciuar procedura ligjore për lirim të pronave publike. Dalje në terren sipas kërkesave të drejtoreve në shumicën e zonave kadastrale komunale. Takim me përfaques të USAID-it për menaxhim të mirë të pronës. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi zbatuar vendimin për zonat kadastrale në Kramovik dhe Gur i Kuq, si zona për destinim solar.

Me kërkesë të qytetarëve kemi përgatitur materiale për kuvendin komunal, si: dhënie e pronave me qira, interes i përgjithshëm, pëlqim për këmbim të pronave komunale me institucione qendrore dhe ato private në shumicën e zonave komunale.

Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovuar me kohë në intranet.

Kemi mbajtur takimet e rregullta me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin Drejtoria, janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe gjashtëmjore, është angazhuar që të gjitha projektet e aktivitetet e parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror - MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport po ashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxe, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe.
- Stadiumin "Jahja Danuza" në Rahovec dhe fushat e tjera sportive.
- Palestrën "Mizahir Isma".

### Aktivitetet:

Gjatë muajve janar-qershor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka organizuar aktivitete të ndryshme sipas planit të punës:

- Vitin e kemi nisur me organizimin e manifestimeve përkujtimore e kulturore - 27 Janar "Flaka e Janarit", me ç'rast është shpallur konkursi letrar "Pena e Flakës".

- Aktivitet kulturore e sportive në shënim të Ditës së Pavarësisë, më 17 Shkurt.
- Në bashkëpunim me OVL- UÇK-në, kemi organizuar aktivitet për nder të Epopesë së UÇK-së, më 5, 6, 7 mars.
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka vazhduar me mbështetjen e projekteve të OJQ-ve, të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën tonë, këtë vit përfitues nga subvencionet kanë qenë 23 OJQ, në shumë prej 157.100eu, gjatë vitit 2023 OJQ-të kanë përfituar 30% më shumë se vitin e kaluar, ku kjo mbështetje do të vazhdojë për çdo vit.
- Java e Dëshmorëve 5-12 maj, Festivali i folklorit “Anadrinia jehon”, më 11,12,13 maj.
- Aktivitet më 14 Qershori - Dita e Çlirimt, më 17 Qershori - shënnimi i ditëlindjes së kolosit të kombit tonë Ukshin Hoti dhe ndarja e Dekoratës me emrin e tij.
- Gjatë kësaj periudhe janar-qershori, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, me nxënësit e shkollave të mesme, kemi organizuar vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë.

#### Investimet Kapitale:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është duke punuar në ndërtimin e terreneve sportive, ku më datë 27.4.2023 është bërë përrimi i fushës sportive në fshatin Gexhë;

- Punimet në ndërtimin e fushës sportive, në Malësi të Vogël, kanë filluar më datë 3.5.2023 dhe janë duke vazhduar;
- Ndërtimi i Kompleksit Muzeor “Ukshin Hoti” në Krushë të madhe.
- Ndërtimi i Aneksit te Shtëpia e Kulturës në Krushë të Madhe, punimet janë duke vazhduar dhe jemi në fazën e dytë të punimve, ku do të bëhet suvatimi dhe rregullimi i hapsirës së brendshme të objektit.
- Ndërtimi i Kompleksit Sportiv - punimet janë duke vazhduar në rregullimin e këtij kompleksi, ku do të ketë një fushë të futbollit të madh, dy fusha të basketbollit, dhe shtegun e atletikës.
- Në kuadër të projektit “Ndërtimi i parqeve dhe i këndeve rekreative për fëmijë” - është bërë rregullimi i Parkut te stacioni i autobusave, përrimi i parkut brenda muajit qershori.

#### Biblioteka komunale “Sulejman Krasniqi”- RAHOVEC

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare; Klasifikimi dhe katalogimi i librit.
- Në Biblioteken Komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, më 21.3.2023, u përruua Këndi shkencor “Sabahajdin Cena”.
- Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Poezisë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi orë letrare me krijues dhe nxënës të shkollave të mesme e fillore të Rahovcit.
- Në Biblioteken komunale “Sulejman Krasniqi”, këtë vit, më datë 28.3.2023, Biblioteka është pasuruar me 1622 ekzemplarë nga MKRS-ja.
- Fondi total i librave në bibliotekë është 27.814 ekzemplarë.

### Palestra sportive “Mizahir Isma”

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në palestrën sportive “Mizahir Isma”, janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klubet e Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtar.

Klubet sportive, si: Basketbolli, Hendbolli, Futsalli kanë zhvilluar aktivitete të shumta në Palestrën sportive “Mizahir Isma”, vlen të ceket se, më datë 16.2.2023, është mbajtur kupa e Kosoves në Basketboll “Final 8”.

### DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Raporti të cilin po e prezantojmë, pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese, për periudhën: janar – 9 qershor të vitit 2023. Në këtë raport janë të përfshira punët dhe aktivitetet e kryera dhe të ndërmarrë nga Drejtoria për Punë Inspektuese të cilat janë paraqitur sipas sektorëve të cilët i mbulojmë si dikaster. Inspektimet kanë për qëllim: Zbatimin e ligeve dhe të akteve të tjera nënligjore, mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të subjekteve të inspektimit.

### AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE

Gjatë periudhës janar – qershor, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet janë realizuar në tërësi duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI-ja është organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00 - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë.

- Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë realizuar afro 540 kontolle inspektuese. Krahë prioriteteve, siç janë: Parandalimi i ndërtimeve pa leje, Lirim i hapësirave publike, Luftimi i ekonomisë së zezë, Mbrojtja e konsumatorit, prioritet dhe fokus i yni kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve;
- Të gjithë shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste, u janë shpërndarë urdhëresa për t'u pajisur me lejet përkëse për shfrytëzim të hapësirave publike, përkizazi me rregulloren komunale;
- Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 56 është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë;
- 56 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;
- Janë kryer inspektime intensive, ku inspektorët e tregut kanë konstatuar parregullësi, po ashtu kanë marrë masa në përputhje me ligjin: gjoba si dhe masa të tjera administrative;
- Janë inspektuar 58 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar, vendosjen e çmimeve në produkte etj.;
- Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektori përkatës, janë iniciuar në Gjykatën për Kundërvajtje 6 fletëparaqitje për ndërtim pa leje dhe dy kërkesa për kundërvajtje komunale për ekzekutimin e gjobave përmbarimore;
- Janë inspektuar edhe disa prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisja me Leje Mjedisore;

- Në fushën e transportit public, ne, në vazhdimësi, kemi përcjellë nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve, se a janë duke i mbuluar mjafsheshëm dhe sigurt linjat e transportit të udhëtarëve, në rendet e udhëtimit të cilat janë lëshuar nga organi kompetent komunal. Po ashtu, janë kryer inspektime rutinore, ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve;
- Janë shqyrtuar me kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve për dalje në terren, kryesish kërkesa në lidhje me çështjet komunale;
- Në bashkëpunim me DGJKP-në, kemi identifikuar raste të ndryshme të usurpimeve arbitrale, si dhe në koordinim me DBF-në, Stacionin Policor në Rahovec, është rrënuar një objekt në pronë publike në fshatin Xërxë, aksioni do të vijojë ditëve në vazhdim edhe pas kalimit të afateve të vendimeve, vlen të ceket se disa vendime janë zbatuar vullnetarisht nga usurpatorët dhe prona publike është liruar;
- Nga USAID-i, kemi pranuar udhëzuesin përfundimtar dhe instrumentin për përcjelljen e protokolleve të inspektimit të ndërtimit, do të organizohen edhe trajnime për mënyrën e përdorimit të këtij instrumenti gjatë punës së përditshme të inspektorit të ndërtimit.

### STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERË E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	40	16,300 €
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE - GËRMIM PA LEJE, EKSPozIM I MALLRAVE USHQIMORE, SHFRYTËZIM I HAPËSIRËS PUBLIKE	18	2000€
GJOBA MANDATORE PËR MUNGESË DOKUMENTACIONI, MOSPËRPUTHJE ÇMIMESH	4	2000€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	3	300 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	18	660 €
<b><u>TOTALI:</u></b>	<b><u>83</u></b>	<b><u>21,290€</u></b>

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERË NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	17	170 €
PËLQIME PUNE	59	885€
<b><u>TOTALI:</u></b>	<b><u>44</u></b>	<b><u>990 €</u></b>

**TOTAL TË HYRA PËR KËTË PERIUDHË RAPORTUESE: 22,280€**

### DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Në kuadër të kompetencave dhe të detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-qershori 2023, Drejtoria për Mbrotje dhe Shpëtim, ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2023. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë,

bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin sukseshëm punën gjashtëmujore të DMSH-së dhe NJPZSH-së.

- Gjatë periudhës janar - qershori, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë, specifisht në pikat kyçë, ku situata shihet më e rënduar, bëhet disa herë në vit, në mënyrë që të eleminohet rreziku për vërvshime. Pas incizimit të gjendjes në terren, u kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku ka pasur nevojë për ndërhyrje.
- Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
- Është kryer servisimi i parë për vitin 2023 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike, në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.
- Inspektori për parandalim ka pasur 7 verifikime për dhënien e pëlgimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 11 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.

Në këtë gjashtëmuor, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:

- Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajtë korrik dhe gusht, në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejet i madh, si pasojë e temperaturave të larta.
- Dokumenti për Ngritjen e Gativës së Emergjente për muajtë korrik dhe gusht për vitin 2023, me të dhënat e dala nga ky dokument, synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojtë pronës dhe të jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.
- Ekipi i zjarrfikësve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, ka marrë gjithsej pesëdhjetë e gjashtë kërkesa për intervenime.

për periudhën kohore: Janar - Dhjetor 2023 - Komuna Rahovec

Realizimi i numrit të përgjithshëm të dëjave, struktura e zjarreve dhe int. tjera janar-dhjetor 2020												
2023	Nr.i përgj. i dëjave	Nr.i zjarreve	Nr.i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente	Vershime	Të përgjithshëm	Të ienduar	Të vdekur	Gjithsej		
	zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot			
Janar	8	5	0	1	1	1	0	0	0	0	0	8
Shkurt	17	12	0	5	0	0	0	0	0	0	0	17
Mars	11	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11
Prill	9	4	2	1	2	0	0	0	0	0	0	9
Maj	11	4	0	5	1	1	0	0	0	0	0	11
Qershori												

Më 4 Maj 2023, me një aktivitet simbolik, shënuam Ditën Ndërkombëtare të Zjarrfikësve.

## PËRFUNDIM

Ky raport përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe reportuese.

Raporti i punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në fryshtë e transparencës, llogaridhënieve dhe performances sa më të mirë komunale dhe u dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që, përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimave apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Jemi të vetëdijshëm për synimet që i kemi vënë vetes, dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit presin me të drejtë nga ne. Kur kemi shpalosur programin tonë qeverisës dhe vizionin tonë për Rahovecin, në fillim na është thënë se është ambicioz dhe vështirë i arritshëm, por për më shumë se tetë jet qeverisje, të gjithë së bashku, jemi dëshmitarë se vizioni ynë për Rahovecin po jetësohet.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi gatishmërinë, energjinë dhe diturinë, të gjitha këto të vëna në dispozicion të qytetarëve, që Komuna e Rahovecit të ofrojë shërbime sa më cilësore.

Të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, duke krijuar kushte më të mira për: zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, do të angazhohemi edhe më tutje të punojmë në të mirën e të gjithëve pa dallim.

Ju faleminderit!

Rahovec, 23 qershor 2023

Smajl Latifi

Kryetar i Komunes

